



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË

Nr. 163/1 Prot.

Tiranë, më 11/03/2015

Lënda : Dërgohen rekomandime lidhur me projekt-ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7961, datë 12.07.1995, “ Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Drejtuar : z.Erion Veliaj
Ministër
Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë

TIRANË

I nderuar zoti Veliaj!

Në vijim të ftesës Tuaj për të dhënë mendime lidhur me projekt-ligjin, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7961, datë 12.07.1995, “ Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dërguar me shkresën nr. 961prot.,datë 11.02.2015, sa më poshtë po Ju parashtrojmë rekomandimet tona:

Në rradhë të parë, dëshirojmë të theksojmë se Komisioneri në vitin 2012 ka dhënë disa rekomandime lidhur me projekt-ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7961, datë 12.07.1995, “ Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të përciell nga Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Nga shqyrtimi i tekstit të këtij projekt-ligji konstatojmë se një pjesë e madhe nga rekomandimet tona kanë gjetur pasqyrim në këtë projektligj të përciell nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. Disa ndryshime të cilat vlerësojmë se duhen pasqyruar janë:

1. Në kreun VII te Kodit te Punës tek : “Detyrimet e Përgjithshme te Punëdhënësit” , **rekomandojmë** formulimin e një neni të veçantë me titull “Mbrojtja nga Diskriminimi në Punësim”, formulimi i të cilit duhet të jetë në përputhje me nenet 12,13, 14,15 dhe 16 të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

2. **Rekomadojmë** rishikimin e nenit 107 të Kodit të Punës në mënyrë që të përfshihet edhe punëmarrësi mashkull i cili ka marrë lejen e birësimit.

3. Për sa i përket procedurave të parashikuara në nenin 58 të projekt ligjit e në vazhdim duhen parë me vëmendje në mënyrë që të harmonizohen me parashikimet që bën ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në kreun VI, procedurat para gjykatës. Një person që në bazë të ligjit 10 221 mund të paraqesë kërkesë padi përpara gjykatës dhe ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim për diskriminimin, dëmshpërblim që i shtohet dëmshpërblimeve apo masave të tjera që parashikohen në ligje të tjera. Direktivat bejnë të njejtin parashikim si ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Zgjidhja e kontratës së punës është një nga momentet e punësimit, kështu që në rast se personi do të pretendojë në padi diskriminim në punësim dhe pikërisht diskriminim në zgjidhjen e kontratës së punës, ai duhet të ketë të drejtën që përveç dëmshpërblimit për zgjidhje të padrejtte të kontratës duhet të përfitojë edhe dëmshpërblim për diskriminim. Një person mund të pretendojë përpara gjykatës edhe se është diskriminuar gjatë procedurave të rekrutimit, që sipas ndryshimeve në Kod por edhe parashikimeve që ekzistojnë në ligjin 10 221 janë pjesë e punësimit. Në ndryshimet që po i behen kodit nuk ka asnjë parashikim si duhet të veprohet, nderkohe se në ndryshimet që i janë bërë nenit 9 të kodit të punës, thuhet se : “ *Te gjitha dispozitat e tjera që kanë të bëjnë me ndalimin e diskriminimit, sikurse percaktohet në ligje dhe akte të tjera, duhet të interpretohen në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Kodin e punës*”. Kodi i punës nuk parashikon asnjë gjë për dëmshpërblimin e personit kur konstatohet diskriminimi i tij. Pra duhet të bëhet një rregullim i procedurave para gjykatës për rastet e diskriminimit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERE

Irma BARAKU

